



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.220/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Graçanicë, dega në Pasjan, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Pasjan, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.220/2025, datë 15.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Kosovski Savez, me seli në Graçanicë, dega në Pasjan, të paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Pasjan, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 15.10.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.220/2025, e parashtruar nga subjekti politik Kosovski Savez, me seli në Graçanicë, dega në Pasjan, me të cilën pretendohet përsëritja e numërimit të votave në vendet e votimit 3603/03 dhe 3601/2 në komunën e Parteshit/Pasjanit. Tutje, ka kërkuar shqyrtimi e kamerës së kontrollit në vendin e votimit 3603/03 për shkak të dyshimit të bazuar se ka ndodhur ndryshim i fletëvotimeve, në mënyrë që ato të shpallen të pavlefshme, kurse fletëvotimet të zbrazëta të shpallen të vlefshme. Anëtari i komisionit zgjedhor nga Kosovski Savez në vendin e votimit 3603/03 nuk ishte i pranishëm në hapjen e vendit të votimit, si gjatë gjithë procesit të votimit, për arsyen se ishte i ndaluar në Serbinë Qendrore. Prandaj, në këtë vendvotim ka ndodhur një sërë parregullsish. Andaj kërkojmë anulimin e votimit në vendvotimin 3603/03.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Srpska Lista, me datë 16.10.2025, ka deklaruar se Sladjan Mladenoviq, në emër të subjektit të tij politik, kërkon përsëritjen e numërimit të votave në vendvotimin 3603/3 dhe 3601/2 në komunën Partesh-Pasjanë. Ai në ankesën e tij pohon se ka ndodhur ndryshim i fletëvotimit dhe ata i shpallën të pavlefshme, ndërsa fletëvotimet e zbrazëta i shpallën të vlefshme. Gjithashtu, ai kërkon që për shkak të pamundësisë së anëtarit të tyre të komisionit zgjedhor për t'iu përgjigjur detyrimeve të tyre, të anulohet votimi në

vendvotimin 3603/3, pa shqyrtuar arsyet konkrete dhe, ajo që është më e rëndësishme, pa asnjë provë me të cilën do të vërtetohin pohimet e tyre dhe do të justifikonin një kërkesë të tillë. Në të gjithë ankesën e tyre, ne nuk shohim asnjë lidhje midis ngjarjeve të pretenduara me subjektin tonë politik, as nuk e përmend atë ankesa e tyre. Gjithashtu, duke shqyrtuar ankesën që na është dërguar, ne nuk shohim kuptimin e dërgimit të saj, veçanërisht duke pasur parasysh papërcaktueshmërinë e akuzave dhe, ajo që është më e rëndësishme, mungesën e çdo prove për akuzat kaq serioze dhe kërkesat për përsëritjen e votimit në disa vendvotime. Duke pasur parasysh faktet e përmendura në përgjigjen ndaj ankesës kërkojmë nga PZAP që ankesën ZL.Anr. 220/25 të refuzoj të pabazuar.

Në përgjigje ne ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 16.10.2025 ka deklaruar se: bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja, ecuria, dhe obligimet në vendvotim. Gjithashtu, në bazë të nenit 101 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit. Lidhur me procedurat për trajtimin e fletëvotimeve, gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit, zbatohen procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr.12/2024, përfshirë edhe trajtimin e fletëvotimeve të dëmtuara apo të pavlefshme. Në bazë të nenit 15 paragrafi 7.2.3 të kësaj Rregulloreje, fletëvotimet e dëmtuara trajtohen sipas procedurës së përcaktuar, duke u numëruar dhe vendosur në zarfet përkatëse për fletëvotime të dëmtuara. Ndërkaq, sipas nenit 16 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 12/2024, përcaktohen qartë kriteret për vlefshmërinë e fletëvotimit dhe votës, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha nivelet e administrimit zgjedhor.

KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 15.10.2025 ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Partesh, nga e cila ka marrë përgjigjen dhe konfirmimin si më poshtë:

KKZ në Partesh ka deklaruar: "Pas votimit dhe mbylljes së vendvotimeve, Këshilli i vendvotimit në VV 3601/02 filloi numërimin e votave sipas procedurës dhe manualit të KQZ-së. Në atë VV, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e KVV, përfshirë anëtarin e partisë politike Kosovski Savez, Andjela Stojković, e cila nënshkroi të dy formularët dhe u pajtua me rezultatet e votimit. Pas marrjes së kutive të votimit, KKZ-ja në Partesh nuk konstatoi se kishte ndonjë parregullsi në formular. Pas numërimit të votave në QKN, ekipi i numërimit nuk gjeti ndonjë korrigjim në fletëvotime nga numërimi në VV-në e rregullt. Në ekipin për numërimin e votave në QKN, kur u numërua VV 3601/02, ishte edhe një anëtar nga subjekti Kosovski Savez, Zlatko Trajković, i cili pati një pasqyrë të numërimit. Prandaj, besoj dhe pretendoj se nuk ka pasur ndryshim të votave në VV- në e rregullt, as në ekipin për numërimin e votave. Në ditën e votimit dhe gjatë numërimit në vendvotimin 3603/03, anëtari i SP Kosovski savez nuk ishte i pranishëm dhe ata nuk kishin të drejtë për zëvendësim sipas formulës së KQZ-së. Gjatë numërimit të votave, 4 anëtarë ishin të pranishëm në VV të cilët nuk raportuan asnjë kundërshtim apo manipulim gjatë numërimit të votave dhe i kanë nënshkruar formularët. Gjatë numërimit në QKN, ku ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i tyre Zlatko Trajković, ekipi i

numërimit nuk vërtetoi se kishte pasur ndonjë manipulim gjatë numërimit në VV të rregullt. Prandaj, besoj se nuk kishte manipulim gjatë numërimit në VV në ditën e zgjedhjeve.

Shënim: Zlatko Trajkovic, anëtar i ekipit të numërimit në QKN, kishte vërejtje ndaj procesit të numërimit të votave për kandidatët sepse subjekti politik NUK KISHTE kandidatë për këshilltarë (anëtarë të Kuvendit të komunës), por vetëm bartësin e listës, gjë që mendoj se ai nuk e ka kuptuar që përveç bartësit të listës, asnjë kandidat nuk merr votë sepse nuk kishin kandidatë të tjerë. Unë u përpoqa vazhdimisht t'i shpjegoja se vota shkon vetëm bartësit të listës për asamblenë por duket se nuk ia dola". (shih të bashkangjitur deklaratën e KKZ).

Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj, të paraqitura në ankesë. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 15.10.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në vendvotim pas mbylljes së vendvotimit lidhur me mospërputhje të votave me nënshkrime të votuesve.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 15.10.2025, në ora 13:05, ndërsa parregullsia për të cilin pretendon pala ankuese është bërë me datë 12.10.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Kosovski Savez, me seli në Graçanicë, dega në Pasjan, për shkak të parregullsive në vendvotim, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së, i cili përcakton se: *"Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP-i, vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj"*, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor"*.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 119 paragrafi 1, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijs së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.220/2025, datë 17.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.